



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Raporti i Auditimit të Performancës

EFIKASITETI DHE EFEKTIVITETI I GRUMBULLIMIT TË MBETURINAVE TË AMVISËRISË NË KRYEQYTET

Prishtinë, maj 2026

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, të cilit Kushtetua dhe Ligji¹ i garantojnë pavarësi funksionale, financiare dhe operative.

Zyra Kombëtare e Auditimit është institucion i pavarur, i cili e ndihmon Auditorin Përgjithshëm në kryerjen e detyrave të tij/saj. Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të kontribuojmë në mënyrë efektive në llogaridhënien e sektorit publik, duke promovuar transparencën publike dhe qeverisjen e mirë, dhe duke nxitur ekonominë, efektivitetin dhe efikasitetin e programeve qeveritare për të mirën e të gjithëve. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike. Auditori i Përgjithshëm i jep llogari Kuvendit për ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të përcaktuara në Kushtetutë, në Ligj, në aktet nënligjore dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 3000²).

Auditimet e performancës të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me parimet e ekonomisë³, efikasitetit⁴ dhe efektivitetit⁵ dhe nëse ka vend për përmirësim.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me përmbajtjen e raportit të auditimit të performancës “Efikasiteti dhe efektiviteti i grumbullimit të mbeturinave

-
- 1 Ligji 05_L_055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës
 - 2 Standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës bazuar në Standardet e Auditimit të ONISA-s dhe përvoja praktike
 - 3 Ekonomia - Parimi i ekonomisë nënkupton minimizimin e kostos së burimeve. Burimet e përdorura duhet të jenë në dispozicion në kohën e duhur, në sasinë dhe cilësinë e duhur dhe në çmimin më të mirë të mundshëm.
 - 4 Efikasiteti - Parimi i efikasitetit nënkupton marrjen e maksimumit nga burimet në dispozicion. Ka të bëjë me lidhjen mes burimeve të përfshira dhe rezultatit të dhënë në aspektin e sasisë, cilësisë dhe kohës.
 - 5 Efektiviteti - Parimi i efektivitetit nënkupton arritjen e objektivave të paracaktuara dhe arritjen e rezultateve të pritshme.

të amvisërisë në kryeqytet” në konsultim me Ndhmës Auditoren Përgjithshme, Myrvete Gashi Morina, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Ekipi që e realizoi këtë raport:

Arben Selimi, Drejtor i Departamentit të Auditimit të Performancës
Edona Abazi, Udhëheqëse e ekipit; dhe
Gazmend Namani, Anëtar i ekipit;

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT – Adresa:Rr. Ahmet Krasniqi nr. 210, Lagjja Arbëria,
Prishtinë 10000, Kosovë
Tel: +383(0) 38 60 60 04/1011
<http://zka-rks.org>

Tabela e përmbajtjes

Përmbledhje e përgjithshme	1
1. Hyrje.....	5
2. Objektivi i auditimit	9
3. Gjetjet e auditimit.....	11
3.1.Mbikëqyrja dhe llogaridhënia nuk ka funksionuar nga asnjëri akter përgjegjës i procesit	12
3.2.KRM Pastrimi nuk ishte efikase në përdorimin e asteve operacionale dhe investive	16
3.3.Sistem i paqëndrueshëm tarifor dhe dobësi në arkëtimin e faturave.....	27
4. Konkluzionet	35
5. Rekomandimet.....	39
Shtojca 1. Kriteret, fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit ...	43
Shtojca 2: Letër konfirmimi	52
Shtojca 3: Vlerësimi i planit të biznesit të KRM Pastrimi	53

Lista e Shkurtesave

Komuna	Komuna e Prishtinës
KRM Pastrimi	Kompania Rajonale e Mbeturinave 'Pastrimi'
OE	Operatori Ekonomik
SMART	Specifike, Të matshme, Të arritshme, Relevante dhe Të kufizuara
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit

Përmbledhje e përgjithshme

Ky auditim është kryer me qëllim të vlerësimit të efikasitetit dhe efektivitetit të Komunës së Prishtinës në organizimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave, duke marrë në konsideratë rëndësinë thelbësore të këtij shërbimi për mbrojtjen e shëndetit publik, ruajtjen e mjedisit dhe sigurimin e një cilësie të qëndrueshme jetese për qytetarët.

Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit është se Komuna nuk ka arritur të jetë efikase as efektive në grumbullimin e mbeturinave gjatë viteve të fundit. Situata e rënduar e mbeturinave në kryeqytet, e reflektuar përmes mbingarkimit të kontenierëve dhe shpërndarjes së mbeturinave nëpër trotuare dhe hapësira publike, paraqet dëshmi të dukshme dhe lehtësisht të verifikueshme edhe nga qytetarët.

Përmbledhja e gjetjeve kryesore të auditimit



Komuna nuk ka zbatuar mekanizma efektiv të kontrollit, mbikëqyrjes dhe llogaridhënies ndaj KRM Pastrimi, duke mos siguruar monitorim të strukturuar dhe sistematik të procesit për grumbullimin e mbeturinave. Njëkohësisht, KRM Pastrimi nuk ka respektuar procedurat e raportimit ndaj Komunës, duke mos ofruar të dhëna të plota për planet operative dhe ofrimin e shërbimeve. Po ashtu, Komisioni i Aksionarëve dhe Bordi i Drejtorëve nuk kanë ushtruar mbikëqyrje efektive në zinxhirin e qeverisjes dhe përgjegjësisë institucionale.



KRM Pastrimi nuk ka arritur të sigurojë funksionim efikas të flotës së kamionëve, duke u ballafaquar me dobësi në planifikimin operacional dhe menaxhimin e aseteve, investime jo efektive në flotë, çka ka rezultuar në kapacitete operative të kufizuara dhe shërbime jo të kënaqshme për qytetarët.



Komuna nuk ka siguruar shpërndarje dhe menaxhim efektiv të kontenierëve, pasi 889 kontejnerë dhe shporta qëndrojnë të papërdorura, ndërkohë që në shumë pika të grumbullimit vërehen kontejnerë të dëmtuar ose jashtë funksionit dhe mungesë e tyre.



Komuna ka kontraktuar operator privat për grumbullim të mbeturinave që ka rezultuar me kosto më të lartë për ton. Komuna nuk ka kryer një analizë të strukturuar dhe paraprake të koston para kontraktimit të operatorëve privatë, gjë që ka rezultuar me kosto më të lartë për Komunën. Operatori Privat ishte më i kushtueshëm me rreth 10 euro/ton krahasuar me Kompaninë Publike, duke rritur kostot e Komunës për grumbullim të mbeturinave për 149 mijë euro, për periudhën prill-dhjetor 2024.



Kompania nuk ka arritur të sigurojë performancë financiare të qëndrueshme për shkak të nivelit të ulët të arkëtimit të faturave, duke zvogëluar kapacitetin për të realizuar objektivat investive. Për më tepër në vitin 2025, kur përgjegjësia e faturimit dhe arkëtimit ka kaluar tek KRM Pastrimi, të hyrat e realizuara ishin dukshëm më të ulëta (vetëm 21% të faturimit) krahasuar me vitet paraprake, gjë që mund të rrezikojë aftësinë e KRM-së për të bërë investime edhe në të ardhmen.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka dhënë 12 rekomandime për Komunë e Prishtinës dhe për KRM Pastrimi, që synojnë adresimin e këtyre mangësive sistematike. Këto përfshijnë: sigurimin që mekanizmat e kontrollit dhe llogaridhënies funksionojnë, rritjen e efikasitetit të operacioneve të KRM-Pastrimi, planifikim dhe shpërndarje

të kontejnerëve sipas nevojës në teren, vendosjen e pajisjeve GPS në kamionë, arkëtimin e plotë të faturimeve si dhe sigurimin e një analize ekonomike në rast të kontraktimit të operatorëve privat.

Përgjigja e Komunës

Komuna e Prishtinës nuk ka kthyer përgjigje lidhur me konkluzionet dhe rekomandimet tona. Inkurajojmë Komunën që ti bëjë të gjitha përpjekjet për t'i adresuar rekomandimet e dhëna.

Përgjigja e KRM Pastrimi

KRM Pastrimi është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit si dhe është zotuar se do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

HYPER

10

1. Hyrje

Menaxhimi i mbeturinave në Komunën e Prishtinës është funksion me rëndësi të veçantë për mjedisin dhe shëndetin publik. Në një kryeqytet me popullsi në rritje siç është Prishtina, shërbimi i pastrimit nuk është thjesht nevojë por kusht për zhvillim të normal të jetës. Një qendër e pastër është pasqyrë e përgjegjësisë së qytetarëve dhe institucioneve. Duke ofruar shërbim cilësor dhe në kohë të mbledhjes së mbeturinave mbrohet shëndeti publik, ruhet mjedisi, biodiversiteti dhe burimet natyrore, të cilat ndikojnë në cilësinë e jetës dhe kanë ndikim pozitiv në turizëm dhe investime. Komuna e Prishtinës është përgjegjëse që të gjithë personave fizik dhe juridik brenda territorit të saj t'u sigurojë shërbim cilësor të grumbullimit të mbeturinave⁶.

Shërbimet e mbledhjes së mbeturinave realizohen nga Kompania Rajonale e Mbeturinave 'Pastrimi' (tutje KRM Pastrimi) në bazë të kontratës së lidhur me Komunën e Prishtinës, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Mbeturina, i

cili përcakton përgjegjësinë e komunës për organizimin dhe sigurimin e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave për të gjithë personat fizikë dhe juridikë brenda territorit të saj. Qëllimi kryesor i kontratës është mbledhja dhe deponimi i mbetjeve të amvisërisë, mbetjeve voluminoze dhe atyre inerte në të gjithë territorin e komunës. Kushtet për ekzekutimin e shërbimeve të pastrimit bazohen në rregulloren për menaxhimin e mbeturinave, të miratuar nga Kuvendi Komunal.

Të ardhurat e gjeneruara nga kjo kontratë, KRM Pastrimi duhet t'i përdorë për mbulimin e shpenzimeve operative dhe investimeve⁷ me qëllim të përmirësimit të cilësisë së shërbimit brenda njësisë së tyre në Prishtinë, duke përfshirë investime në makineri, pajisje dhe staf profesional.

6 Ligji për mbeturina nr.04/L-060

7 Plani i biznesit 2024 dhe vlerësimet e hershme për vitin 2025-2026

Foto 1. Evidencë vizuale e gjendjes me menaxhimin e mbeturinave gjatë viteve 2023-2025



Situata e paraqitur në fotografi dëshmon një gjendje të rënduar të grumbullimit të mbeturinave. Kjo gjendje paraqet rrezik të drejtpërdrejtë për shëndetin publik, pasi krijon kushte të favorshme për zhvillimin dhe përhapjen e insekteve dhe brejtësve, të cilët mund të bartin infeksione dhe sëmundje të ndryshme. Rreziku rritet ndjeshëm gjatë periudhave me temperatura të larta, kur proceset e dekompozimit janë më të shpejta dhe fluksi i shtuar i vizitorëve rritë ekspozimin e qytetarëve ndaj këtyre rreziqeve, duke ndikuar negativisht në sigurinë shëndetësore dhe imazhin e qytetit.

OBJEKTIV
KRAJ
JUDITIVIT
002

2. Objektivi i auditimit

Objektivi e këtij auditimi është të vlerësojmë nëse Komuna e Prishtinës dhe KRM Pastrimi janë efikase dhe efektive në ofrimin e shërbimeve për grumbullimin e mbeturinave në kryeqytet, duke shqyrtuar nëse shërbimi ofrohet në mënyrë të rregullt dhe me përdorim optimal të burimeve financiare, njerëzore dhe materiale. Periudha e vlerësimit të këtyre shërbimeve ka përfshirë vitin 2023-2025.

Me theks ky auditim ka vlerësuar nëse proceset e planifikimit, menaxhimit dhe monitorimit të shërbimit janë të strukturuar mirë dhe përmbushin nevojat e qytetarëve, ku kemi identifikuar boshllëqet, sfidat dhe mundësitë për përmirësim.

Pyetjet e auditimit

Për t'iu përgjigjur objektivit të auditimit, ne kemi formuluar pyetjen si më poshtë:

1. A është Komuna efektive dhe efikase në menaxhimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave në kryeqytet?

Fushëveprimi i këtij auditimi përfshinë vlerësimin e sistemit të grumbullimit të mbeturinave nga Komuna e Prishtinës dhe ndërmarrja publike KRM Pastrimi, për periudhën 2023-2025. Kemi analizuar mënyrën se si Komuna ka planifikuar, financuar, mbikëqyrur dhe mbështetur ofrimin e këtij shërbimi publik, si dhe nëse janë ndërmarrë veprime konkrete për të siguruar mbulueshmëri të plotë dhe përdorim racional të burimeve. Gjithashtu, kemi vlerësuar zbatimin e kornizës ligjore dhe rregullative në fuqi nga Komuna.

Në kuadër të këtij auditimi kemi analizuar gjithashtu aktivitetet dhe kapacitetet operacionale të KRM Pastrimi, duke përfshirë strukturën organizative, planifikimin strategjik dhe operativ, menaxhimin e burimeve njerëzore dhe materiale, si dhe sistemet për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave të performancës. Kemi shqyrtuar nëse kompania ka qenë në gjendje të ofrojë shërbimet në mënyrë të vazhdueshme, efikase dhe të qëndrueshme gjatë viteve 2023 - 2025, si dhe nëse janë ndërmarrë masa për përmirësim të vazhdueshëm dhe përballje me sfida të papritura.

GEHEIM
DITIMIT

03

3. Gjetjet e auditimit

Në vijim paraqiten dobësitë e identifikuar në mekanizmat e mbikëqyrjes dhe llogaridhënies ndërmjet Komunës, KRM Pastrimi dhe strukturave tjera drejtuese; mungesë të analizave të kostos-efikasitetit në proceset vendimmarrëse, si dhe menaxhim joefektiv të flotës dhe asetëve tjera. Po ashtu, janë konstatuar mangësi në shpërndarjen dhe mirëmbajtjen e kontenierëve, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimeve për qytetarët. Këto dobësi, të shoqëruara me performancë financiare jo të qëndrueshme, kanë kufizuar aftësinë e ndërmarrjes për të arritur objektivat operative dhe zhvillimore.


3.1. Mbikëqyrja dhe llogaridhënia nuk ka funksionuar nga asnjëri akter përgjegjës i procesit

Komuna duhet të krijojë mekanizma efektivë për monitorimin dhe raportimin e performancës së ndërmarrjes publike që menaxhon mbeturinat në kryeqytet. Këto duhet të përfshijnë objektiva të matshëm, mbledhje të rregullt të të dhënave, raporte periodike dhe analizë sistematike të rezultateve për rritjen e efikasitetit dhe llogaridhënies së KRM Pastrimi.⁸

KRM Pastrimi është kompani publike e organizuar si shoqëri aksionere, në të cilën pjesë të konsiderueshme të aksioneve e ka Komuna e Prishtinës (rreth 77%). Ajo është e kontraktuar për ofrim të shërbimeve për grumbullim të mbeturinave nga Komuna e Prishtinës. Si çdo shoqëri aksionare, KRM Pastrimi i ka mekanizmat mbikëqyrës si: Bordi i Drejtorëve, Bordi i Aksionarëve dhe vet Aksionarët. Pra, janë disa hallka të mbikëqyrjes dhe llogaridhënies të cilat është e kërkuar të zbatohen nga të gjithë palët e përfshira. Mënyra e llogaridhënies është e pasqyruar më poshtë:

8 Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave 2023

Figura 1. Përgjegjësitë e palëve në procesin e raportimit, monitorimit dhe llogaridhënies⁹



Ky proces kishte dështuar të realizohej pothuajse në të gjitha nivelet nga të gjitha palët.

Performanca jo e kënaqshme në grumbullimin e mbeturinave është raportuar nga qytetarët, mediat dhe vet Komuna, që nga viti 2023. Megjithatë kjo çështje nuk është diskutuar në nivlet e ndryshme të mbikëqyrjes dhe llogaridhënies pavarësisht se mekanizmat për këtë qëllim ekzistojnë, për shkak se zyrtarët përgjegjës në këto makeza nuk kanë qenë efektiv në zbatimin e përgjegjësisë së tyre.

9 Sipas Ligjit për ndërmarrjet publike

- **KRM Pastrimi** ka përgatitur planet e biznesit për vitet 2024 dhe 2025 dhe Bordi i Drejtorëve i kishte miratuar të dyja. Përveç që janë pothuajse identike në përmbajtje, me dallime minimale mes tyre, ato ngjasojnë më shumë me strategji se sa plane konkrete të biznesit. KRM Pastrimi kishte përcaktuar objektivat por ato janë të formuluar në mënyrë të përgjithësuar dhe nuk janë të qarta, konkrete, të matshme apo të përcaktuara në kohë, rrjedhimisht nuk i përmbushin kriteret e objektivave SMART - specifike, të matshme, të arritshme, relevante dhe të kufizuara në kohë (shih Shtojca nr. 3 për vlerësimin e planit të biznesit).

Për këtë shkak, këto plane nuk i kanë shërbyer Bordit të Drejtorëve si instrumente efektive për kontroll, mbikëqyrje dhe llogaridhënie.

- **Bordi i Drejtorëve të KRM Pastrimi** nuk ka ushtruar mbikëqyrje efektive mbi veprimtarinë e KRM-së, sepse në takimet e Bordit nuk ishte trajtuar pothuajse asnjëherë problematika aktuale e mbeturinave në qytet. Në vend të kësaj Bordi ishte marrë me çështje tjera si çështje financiare dhe administrative të KRM-së. Pavarësisht se problematika lidhur me grumbullin e mbeturinave në teren ka qenë evidente, Bordi i Drejtorëve nuk ka kërkuar nga Kryeshefi Ekzekutiv një raport shpjegues mbi arsyet e performancës së dobët, as nuk ka kërkuar që të ndërmerren veprime adekuate për përmirësim të gjendjes.
- **Komisioni Komunal i Aksionarëve** i KRM Pastrimi nuk ka ushtruar mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze mbi veprimtarinë e Bordit të Drejtorëve dhe të Ndërmarrjes Publike edhe pse janë mbajtur takime të rregullta vjetore të Aksionarëve. Në Kuvendin vjetor të vitit 2024 Aksionari që e ka pjesën më të madhe të aksioneve në KRM, Komuna e Prishtinës, nuk kishte marrë pjesë. Në Kuvend, Kryeshefi Ekzekutiv kishte parashtruar pikëpamjet e tij për sfidat operative duke paraqitur si shkak kryesor makineritë e vjetruara, sidomos në Prishtinë, por asnjëri prej aksionarëve nuk e kishte sfiduar, atë e as anëtarët e Bordit të Drejtorëve, me pyetje rreth gjendjes së rëndë me mbeturina në kryeqytet. Kuvendi Vjetor i Aksionarëve i vitit 2025 nuk u mbajt për shkak të mungesës së kuorumit. Asnjë nga tre aksionarët e Komunës së Prishtinës nuk kishin marrë pjesë në Kuvend. Dy nga ta ishin tërhequr nga Komisioni (sipas zyrtarëve të Komunës) me rastin e prishjes së koalicionit qeverisës (mes partisë në pushtet lokal dhe opozitës). Disa anëtarë tjerë të Komisionit munguan për arsye subjektive (personale). Kështu Kuvendi nuk u mbajt fare, pavarësisht se anëtarët kishin mundësinë për të shtyrë mbledhjen për një datë tjetër, për të autorizuar përfaqësues ose për të marrë pjesë nga distanca (on-line).

- **Kuvendi Komunal** nuk i kishte emëruar dy aksionar të rinjë në vend të atyre që ishin tërhequr nga Komisioni i Aksionarëve. Rrjedhimisht, çdo hallkë e strukturës mbikëqyrëse/llogaridhënëse kishte rezultuar plotësisht jo efektive.

Megjithëse ky kanal i komunikimit nuk ishte efektiv, Komuna, përmes një marrëveshje me KRM Pastrimi, kishte krijuar një kanal tjetër komunikimi, raportimi dhe llogaridhënie. Drejtoria e Shërbimeve Publike në mënyrë formale dhe joformale kishte komunikuar me KRM Pastrimi. Megjithatë, as kjo formë e komunikimit nuk kishte sjellë rezultate më të mira, sepse nuk kishte kontribuar në përmirësimin e gjendjes me mbeturina në qytet.

KRM Pastrimi nuk kishte dorëzuar Planin e Itinerarit Operativ dhe oraret mujore, edhe pse parashihej në marrëveshje. Kjo kishte ndodhur, sipas KRM Pastrimi, sepse Komuna nuk i kishte kërkuar ato asnjëherë. Komuna nuk kishte shqiptuar as gjobë ndaj KRM Pastrimi për shërbimin e dobët, sipas Komunës, me qëllim të mos rëndimit të gjendjes financiare të KRM-së, duke marrë parasysh problemet që kishte kjo e fundit në atë kohë me borxhe dhe mungesë të buxhetit për investime.

Si rezultat i planit të biznesit jo konkret dhe jorealit, objektivave jo të matshme, mungesës së të dhënave, të raporteve periodike dhe të analizës sistematike të rezultateve, *Bordi nuk kishte shërbyer si mekanizëm efektiv i kontrollit, nuk kishte vlerësuar si duhet performancën e KRM-së dhe për pasojë Kryeshefi Ekzekutiv nuk kishte ndërmarrë veprime korigjuese.*

As Komisioni i Aksionarëve nuk ka qenë efektiv në mbikëqyrje dhe kërkim të llogaridhënies nga Bordi i Drejtorëve kryesisht për shkak të mungesës së aksionarit më të madh në Kuvendet vjetore. Për më tepër, Komisioni nuk ka qenë funksional në vitin 2025 për shkak të mungesës së kuorumit.

Mungesa e mbikëqyrjes, raportimit dhe llogaridhënies efektive mbi operacionet e mbledhjes së mbeturinave, përkatësisht të KRM Pastrimi, ka rezultuar që Komuna të mos ketë kontroll mbi gjendjen e shërbimeve të mbledhjes së mbeturinave në terren dhe resurset e përdorura për këtë qëllim, që më pas ka rezultuar me menaxhim të dobët të mbledhjes së mbeturinave.

3.2. KRM Pastrimi nuk ishte efikase në përdorimin e asteve operacionale dhe investive

KRM Pastrimi duhet të ketë plane të detajuara për shfrytëzimin e infrastrukturës dhe pajisjeve në dispozicion, përfshirë automjetet (kamionë, kontejnerë, etj.) dhe burimet njerëzore, në mënyrë të koordinuar dhe efikase për zbatimin e planit operativ. Kjo përfshin sigurimin që infrastruktura e nevojshme të jetë mirëmbajtur dhe e gatshme për përdorim, dhe që stafi të jetë i trajnuar dhe i angazhuar në realizimin e detyrave të planifikuara. Përdorimi efikas i burimeve duhet të garantojë që aktivitetet e planifikuara për mbledhjen dhe menaxhimin e mbeturinave të realizohen sipas afateve dhe standardeve të përcaktuara¹⁰.

3.2.1. Mungesë e kontrollit efektiv mbi flotën e kamionëve

Në raportet mujore mbi shfrytëzimin e kamionëve për periudhën 2023–2025, për shumicën e kamionëve figuron se kilometrat e përshkruar janë zero “0”, ndërkohë që për të njëjtët kamionë janë raportuar sasi të bartura të mbeturinave dhe shpenzime për karburant.

Kjo kishte ndodhur për shkak se pajisjet për matjen e kilometrave nuk funksionojnë, sipas KRM Pastrimi. Mungesa e mirëmbajtjes së pajisjeve matëse të kilometrave dhe vjetërsia e kamionëve është shkak kryesor që këta matës janë jo funksional.

Si rezultat, menaxhmenti nuk disponon informata të besueshme, monitorimi i performancës së flotës dhe kontrolli i shpenzimeve operative është i pamundur. Kjo situatë ndikon në menaxhim joefektiv, duke pamundësuar monitorimin e performancës së flotës dhe kontrollin efektiv të shpenzimeve të karburantit. Rritet rreziku për keqpërdorim, humbje financiare dhe keqmenaxhim të burimeve publike.

10 Plani Operativ i KRM Pastrimi dhe Plani i Biznesit 2024 dhe 2025

Tabela 1. Lista e kamionëve për vitin 2023 të cilat kanë pasur probleme me evidentimin e kilometrave

Tipi	Totali - KM	Nafta	KM - GPS	Sas. Mbet. Në Ton
Mercedes	-	2,856	-	699
Ford	-	2,148	-	318
Man	-	2,075	-	431
Isuzu	-	2,073	-	577
Isuzu	-	1,868	-	484
Isuzu	-	1,790	-	475
Isuzu	-	1,473	-	498
Man	-	1,136	-	291
Isuzu	-	1,126	-	312
Man	-	806	-	159
Mercedes	-	729	-	149
Skania	-	718	-	138
Isuzu	-	614	-	140
Man	-	400	-	63
Isuzu	-	261	-	52
Isuzu	-	261	-	43
Ford	-	250	-	-
Skania	-	113	-	-
Mercedes	-	48	-	-

3.2.2. Menaxhim joefikas i flotës së kamionëve

Gjatë procesit të auditimit u evidentuan mangësi të konsiderueshme në organizimin dhe funksionimin operacional, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në përdorim joefikas të burimeve dhe në mangësi për të siguruar ofrim të qëndrueshëm të shërbimeve.

a. Mospërputhje ndërmjet planifikimit dhe kapaciteteve reale operative

Sipas Planit të Itinerarit Operativ (PIO) të vitit 2021, numri i kamionëve të nevojshëm për kryerjen e shërbimeve është prej 15 - 31 kamion aktiv në ditë të caktuara. Sipas zyrtarëve të operativës, ky vlerësim është konsideruar i vlefshëm edhe për vitet në vijim.

Tabela 2. Numri i përgjithshëm i kamionëve sipas planit operativ

Dita	Ndërrimi I	Ndërrimi II	Ndërrimi I	Totali
E hënë-e mërkure	20 kamionë	2 kamionë	9 kamionë	31
E enjte- e premte	19 kamionë	2 kamionë	9 kamionë	30
E shtunë	3 kamionë	2 kamionë	9 kamionë	14
E diele	4 kamionë	2 kamionë	9 kamionë	15

Krahasimi i këtij plani me numrin e kamionëve në dispozicion gjatë viteve 2023-2025 tregon se kapacitetet reale për operim 24h kanë qenë nën nivelin minimal të planifikuar. Analiza sipas PIO-s vlerëson se për një 24 orësh, duhet të jenë në dispozicion 31 kamionë gjatë tri ditëve të para të javës dhe 30 kamionë për dy ditët tjera, kurse 14 dhe 15, respektivisht në ditë fundjave për të mbuluar tërë territorin për ofrim të shërbimeve.

Nga të dhënat ekzistuese rezulton se në vitin 2023 KRM ka operuar me 28 kamionë, në vitin 2024 me 25 kamionë dhe në vitin 2025 me 31 kamionë.

Tabela 3. Mbeturina e grumbullara gjatë viteve 2023-2025

Viti	Kamionët në dispozicion	Mbeturinat e grumbulluara	Mesatarja për kamion
2023	28	80,239 ton	2,866 ton
2024	25	65,728 ton	2,629 ton
2025	31	53,784 ton	1,735 ton

Siç shihet në tabelë KRM Pastrimi ka shënuar rënie vit pas viti në sasinë e mbeturinave të grumbulluara. Rënia në vitin 2024 ka ndodhur për shkak se është angazhuar OE privat që ka mbuluar një pjesë të territorit. Ndërsa në vitin 2025 përveç OE-së privat, KRM Pastrimi ka mbledhur më pak mbeturina për shkak se punëtorët e ndërmarrjes kanë qenë në grevë.

Në intervistë me zyrtarë përgjegjës të operativës nga KRM Pastrimi është potencuar se kamionët nuk rekomandohet të përdoren për më shumë se një ndërrim (rreth 8 orë), sepse rrezikon në defekte teknike serioze, duke qenë se makineritë kërkojnë kohë pauze pas çdo ndërrimi. Kjo situatë rëndohet më tej nga fakti se shumica e kamionëve janë më të vjetër se 10 vite, çka e zvogëlon ndjeshëm kapacitetin e tyre operacional dhe rritë frekuencën e defekteve.

Pavarësisht se numri mesatar i kamionëve në dispozicion i afrohet nevojës së planifikuar, rezultati final në terren paraqitet i pakënaqshëm, përkatësisht gjendja e mbeturinave në qytet vazhdon të jetë problematike, mirëpo jo-efikasiteti i KRM Pastrimi është pasojë e nevojës për mirëmbajtje të shpeshtë të kamionëve.

Kjo ka ndodhur për shkak të dështimit të KRM për të realizuar planet investive¹¹ për zëvendësimin e kamionëve.

b.Disponueshmëri e ulët e kamionëve për shkak të defekteve të shpeshta teknike

Pavarësisht se në listat e pajisjeve numri i kamionëve duket i mjaftueshëm për operime ditore, në praktikë këta kamionë shpesh janë jashtë funksionit për shkak të defekteve teknike. Nga raportet e siguruar nga KRM Pastrimi rezulton se pothuajse çdo javë paraqitet nevojë për intervenim teknik në një ose më shumë kamionë. Këto intervenime shpesh zgjasin disa ditë, duke zvogëluar ndjeshëm numrin real të automjeteve operative.

Sipas të dhënave nga njësia për mirëmbajtje të kamionëve, defektet më të shpeshta kërkojnë ndërhyrje që zgjasin nga 2–3 ditë deri në 7–10 ditë. Sipas një raporti të

11 Bazuar në planet e biznesit 2023 dhe 2024

gjendjes së flotës në muajin tetor 2025, nga 31 kamionë sa i ka gjithsej, 18 prej tyre ishin në proces rregullimi. KRM-ja i ka edhe shtatë kamionë tjerë që janë pasiv dhe jashtë funksionit.

Kjo gjendje kishte ardhur për arsye se nuk ishte bërë përditësimi i planit operativ dhe përdorimi i flotës së vjetruar. Po ashtu, një shkak tjetër është mirëmbajtja reaktive në vend të mirëmbajtjes preventive të kamionëve.

Kjo mund të ndikoj në reduktim të disponueshmërisë operative të kamionëve, mbingarkesë e mjeteve ekzistuese dhe rritje të defekteve teknike, si rrjedhojë edhe ndërprerje të shërbimeve.

3.2.3. Investime të realizuara, por pa përmirësim të kapaciteteve operative

Në vitin 2024, Komuna e Prishtinës ka blerë 8 kamionë të rinj për KRM Pastrimi (të shpërndarë në fillim të vitit 2025), ndërsa vet KRM Pastrimi gjatë vitit 2025 ka blerë 10 kamionë të përdorur në vlerë mbi 340 mijë euro (prej të cilave vetëm gjashtë janë për grumbullimin e mbeturinave të amvisërisë).

Pavarësisht këtyre investimeve, situata operative nuk është përmirësuar në mënyrë të dukshme. Sipas një e-mail të datës 14 nëntor 2025 nga KRM Pastrimi adresuar Komunës së Prishtinës, kompania ka deklaruar se aktualisht janë funksional vetëm 10 -11 kamionë dhe se nuk mund të garantojë ofrimin e shërbimit 24-orësh.

Kjo ka ndodhur për shkak se kamionët përdoren në mënyrë të vazhdueshme në dy deri në tre ndërrime gjatë ditës, gjë që ka rezultuar në mbingarkesë të tyre dhe konsumim të shpejtë të komponentëve mekanikë. Përveç kësaj, disa kamionë që KRM i kishte marrë me qira, nuk i kishte në dispozicion më, si dhe disa prej kamionëve të dedikuar për Komunë të Prishtinës i kishte përdorur në komuna tjera.

Si pasojë e kësaj ngarkese të lartë, janë shfaqur defekte të shpeshta teknike, të cilat kanë kërkuar intervenim në këta kamion. Kjo tregon se investimet e realizuara nuk kanë prodhuar efektin e pritur në rritjen e kapaciteteve operative dhe se ekziston mospërputhje e theksuar ndërmjet investimeve në mjete dhe funksionalitetit real në terren.

Përveç kësaj për aq kohë sa kamionët mbeten në riparim edhe stafi operativ i KRM-së mbetet pasiv.

3.2.4. Vonesa në vënien në shfrytëzim të kamionëve ka ndikuar në uljen e kapacitetit operativ

Komuna duhet të ketë një planifikim financiar afatmesëm dhe afatgjatë të harmonizuar me objektivat strategjike për shërbimet e pastrimit, duke siguruar ndarjen e qëndrueshme të fondeve për investime kapitale që garantojnë zhvillim dhe përmirësim të vazhdueshëm të infrastrukturës dhe cilësisë së shërbimeve.

Megjithëse Komuna kishte planifikuar, blerë dhe pranuar tetë kamionë për mbledhjen e mbeturinave, dorëzimi i tyre tek KRM Pastrimi nuk është realizuar në kohë dhe në përputhje me marrëveshjet e lidhura. Gjashtë kamionë janë dorëzuar me 20 ditë vonesë nga data e nënshkrimit të marrëveshjes, ndërsa dy kamionët e tjerë, ndonëse të pranuar njëkohësisht me të tjerët, janë vënë në shfrytëzim të KRM Pastrimi gjashtë muaj pas blerjes.

E gjithë kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së koordinimit efektiv dhe i planifikimit të pamjaftueshëm ndërmjet ekipit teknik të KRM Pastrimi dhe Komunës së Prishtinës në procesin e pranim/dorëzimit.

Për pasojë gjendja e rënduar me mbeturina në kryeqytet ka vazhduar me muaj të tërë me përmirësim të papërfillshëm. Ky mosveprim nga ana e Komunës ka kontribuar në mos përmirësim të gjendjes veçse të rënduar të mbeturinave në kryeqytet, të cilat kanë vazhduar të shqetësojnë qytetarët, duke degraduar ambientin dhe duke rrezikuar shëndetin publik. Për më tepër, është konsumuar një pjesë e periudhës njëvjeçare të garancisë së koston së servisimit dhe mirëmbajtjes së këtyre kamionëve.

3.2.5. Monitorim joefektiv i flotës si pasojë e mosfunksionalizimit të GPS deri në vitin 2025

Me rastin e kontraktimit të operatorëve privat për ofrimin e shërbimeve të mbledhjes së mbeturinave, Komuna ka vënë në funksion sistemin GPS për monitorimin

e kamionëve. Megjithatë, nuk ekzistojnë të dhëna të hollësishme e as raporte periodike lidhur me lëvizjen e kamionëve me qëllim të zbatimit të itinerareve.


Kjo ka ndodhur për shkak se nuk është caktuar një person i dedikuar ekskluzivisht për monitorimin e flotës, pasi që personat e njejtë mbajnë njëkohësisht edhe përgjegjësinë e menaxhimit të kontratës, ku ju kërkohet të realizojnë edhe verifikime në terren të pikave të grumbullimit.


Kjo situatë kufizon mundësinë për monitorim të vazhdueshëm dhe efektiv të flotës gjatë kohës kur zyrtarët ndodhen në terren.

Gjatë periudhës së zbatimit të marrëveshjes ndërmjet Komunës dhe KRM Pastrimi, nuk ka qenë funksional asnjë mekanizëm për monitorim të vazhdueshëm (24 orë) të flotës së kamionëve që i përket KRM Pastrimi, gjatë kryerjes së punës. KRM Pastrimi kishte vendosur GPS në kamionë gjatë vitit 2025. Por nuk kishte të dhëna të hollësishme e as raporte periodike lidhur me lëvizjen e kamionëve.

Kjo kishte ndodhur për shkak se KRM Pastrimi nuk e kishte zhvilluar plotësisht sistemin e monitorimit të lëvizjes së kamionëve. Vetëm gjatë periudhës së auditimit ishte iniciuar instalimi i sistemit për monitorimin e flotës së kamionëve dhe ishte caktuar një person përgjegjës për këtë funksion. Megjithatë, sistemi ndodhej ende në fazën e testimit dhe sapo kishte filluar funksionimin, nuk kishte prodhuar të dhëna as për një muaj, prandaj nuk ka qenë e mundur të vlerësohet efikasiteti i tij.

Foto 2. Sistemi i monitorimit të flotës në KRM Pastrimi





Mungesa e monitorimit të itinerarit përmes GPS-së deri në vitin 2025 ka ardhur si pasojë e mos sigurimit nga Komuna të pajisjeve të nevojshme për monitorim elektronik, si dhe përdorimit të kamionëve të vjetër nga KRM Pastrimi, gjë që e ka bërë të vështirë instalimin dhe funksionimin e sistemit GPS.

Mungesa e sistemit GPS, ka ndikuar që Komuna dhe KRM Pastrimi të mos kenë mundësi të monitorojnë në kohë reale zbatimin e itinerarit dhe aktivitetin e flotës së kamionëve, duke kufizuar kontrollin mbi mbledhjen e mbeturinave, dhe njëkohësisht duke rritur rrezikun për jo-efikasitet.

3.2.6. Mungesë e planifikimit efektiv dhe shfrytëzimit optimal të kontenierëve

Komuna kishte lidhur dy kontrata brenda vitit 2024 për furnizim me kontejnerë në vlerë afër 747 mijë euro, të dedikuar për KRM Pastrimi për vendosjen e tyre në pikat grumbulluese. Pas furnizimit me kontratën e parë me gjithsej 1,370 kontejnerë, Komuna e kishte vlerësuar të nevojshme edhe lidhjen të kontratës së dytë për 1,900 kontejnerë tjerë, për arsye të mungesës së kontejnerëve funksional. Përveç kësaj, Komuna kishte shfrytëzuar 30% të kontratës duke furnizuar edhe me 570 kontenierë shtesë në vlerë prej 118,595 euro. Deri në tetor 2025 në KRM Pastrimi janë pranuar gjithsej 2,883 kontenierë nga gjithsej 3,840 sa ishin blerë. Me urdhër të Komunës 68 kontejnerë i kishte shpërndarë nëpër pika OE privat.

Megjithatë, gjatë auditimit kemi vërejtur se në shumë pika të grumbullimit kishte kontejnerë të dëmtuar ose jashtë funksionit, si dhe pika me fluks të lartë

të mbeturinave që vazhdojnë të kenë numër të pamjaftueshëm të kontejnerëve, sepse ishin të stërbushur dhe qytetarët detyroheshin të hidhnin mbeturinat jashtë tyre.

Foto 3. Pikë me fluks të lartë, me pak kontejnerë dhe të dëmtuar



Kjo gjendje ka ardhur si pasojë e planifikimit të dobët të shpërndarjes së kontejnerëve të blerë. Një numër i konsiderueshëm i kontejnerëve të blerë nuk ishin shpërndarë ende nëpër pika të grumbullimit të mbeturinave dhe vazhdojnë të qëndrojnë të papërdorur (në Qendrën e Kompostimit). Për momentin janë 889 kontejnerë dhe shporta të cilat ende nuk janë shpërndarë nëpër pika të grumbullimit të mbeturinave për përdorim në qytet.

Furnizimi me kontejnerë është planifikuar dhe miratuar kryesisht mbi bazën e kërkesave të paraqitura nga KRM Pastrimi dhe vlerësimeve në terren, pa u mbështetur në një analizë të mirëfilltë të nevojave reale. Mirëpo në bazë të disa komunikimeve në mes dy palëve, vërehet se KRM ka bërë kërkesë për furnizim dhe caktim të pikave grumbulluese, mirëpo ky veprim është vonuar nga ana e Komunës, sepse sipas tyre procesi i formimit të komisionit vlerësues në terren dhe përfundimi i raportit ka kërkuar kohë.

Mungesa e një vlerësimi të nevojave në teren dhe plani të shpërndarjes ka rezultuar që kontejnerët të mos vendosen aty ku kërkesa është më e lartë, duke mbetur të papërdorur, përderisa problematika në terren ka vazhduar.

Foto 4. Kontejnerët e papërdorur në Qendrën e Kompostimit



3.2.7. Dëmtimi i kontejnerëve dhe mos zëvendësimi i tyre

Në shumë pika të grumbullimit vërehen kontejnerë të dëmtuar të cilët janë jashtë funksionit. Këta kontejnerë nuk largohen dhe njëkohësisht nuk zëvendësohen me të rinj për një kohë të gjatë. Dëmtimi i këtyre kontejnerëve shpesh ka ndodhur nga pakujdesia dhe mungesa e njohurive të stafit gjatë zbrazjes dhe për shkak të papërgjegjësive së qytetarëve.

Foto 5. Kontejnerët e dëmtuar dhe jashtë funksionit



Gjatë intervistave me zyrtarët përgjegjës të KRM Pastrimi është konstatuar se nuk zhvillohen trajnime të rregullta profesionale për stafin e sapo rekrutuar, përveç sqarimeve të përgjithshme gjatë ditëve të para të punësimit. Stafi operativ nuk ka pasur njohuri të mjaftueshme për përdorimin dhe zbrazjen e kontejnerëve, sipas udhëheqësit të Operativës së KRM Pastrimi, duke shkaktuar dëmtime të shpeshta për shkak të pakujdesisë, ulje të efikasitetit operacional dhe rritje të kostove për zëvendësim të pajisjeve.

Si rezultat mbeturinat përfundojnë nëpër trotuare duke e rënduar gjendjen e pastërtisë në kryeqytet.


3.3. Sistem i paqëndrueshëm tarifor dhe dobësi në arkëtimin e faturave

Komuna është përgjegjëse për sigurimin e burimeve të mjaftueshme financiare për ofrimin efektiv të shërbimeve publike dhe për garantimin e stabilitetit financiar, përmes planifikimit të një buxheti adekuat dhe ndarjes së fondeve në përputhje me kërkesat ligjore¹².

3.3.1. Arkëtim i ulët krahas faturimit

Komuna nuk ka qenë efektive në zhvillimin dhe zbatimin e një sistemi funksional tarifor, veçanërisht në aspektin mbledhjes së të hyrave, çka ka rezultuar në rritje të konsiderueshme të llogarive të arkëtueshme (LL/A). Më poshtë paraqitet grafiku që ilustron trendin e arkëtimin të të hyrave të faturuara ndaj qytetarëve për vitet 2023 dhe 2024.

Grafiku 1. Krahasimi në mes faturimeve dhe arkëtimeve në Komunë



12 Plani Komunal i Menaxhimit të Mbeturinave 2023-2027

Faturimet e Komunës për shërbimin e grumbullimit të mbeturinave për vitet 2023 dhe 2024 ishin përkatësisht 4,21 milionë euro dhe 5,61 milionë euro. Regjistrat e Komunës tregojnë se numri i amvisërive të regjistruara në vitin 2023 ishte 74,675 ndërsa në vitin 2024 ishte 75,380.

Kuvendi Komunal e kishte rritur tarifën e shërbimit nga 4.7 euro për njësi banimi, në 6.2 euro, një rritje prej 32%. Prandaj të hyrat e faturuara në vitin 2024 kishin shënuar rritje prej 1,4 milion euro. Mirëpo Komuna kishte arritur të arkëtojë më pak se 3.1 milionë euro ose vetëm 60% të të hyrave të faturuara. Pavarësisht kësaj, Komuna ia kishte paguar KRM Pastrimi tërë shumën e faturuar, në përputhje me marrëveshjen mes tyre.

Të hyrat reale të Komunës nga ky shërbim kishin mbetur të kufizuara për shkak të pamundësisë së arkëtimit, si dhe për shkak se nuk i ka përfshirë klientët e ri në regjistra të faturimit, duke rritur rrezikun për akumulim të mëtejme të LL/A dhe krijim të humbjeve potenciale.

3.3.2. Mos përfshirja e njësive të reja të banimit në regjistrin e klientëve


Komuna e Prishtinës kishte faturuar në vitin 2023 gjithsej 74,675 amvisëri ndërsa në vitin 2024 ishin 75,380 amvisëri, duke shënuar një rritje të numrit të klientëve për 705 njësi. Ky numër nuk përputhet me numrin amvisërive që kishte identifikuar dhe regjistruar KRM-ja, sepse është më i vogël për afër 16 mijë njësi banimi. KRM Pastrimi kishte kërkuar që këta klientë të përfshihen në regjistra të faturimit, rrjedhimisht edhe në marrëveshjen mes tyre. Megjithatë numri i klientëve në marrëveshjen mes Komunës dhe KRM-së kishte mbetur afërsisht i njëjtë në të dy vitet, 72,847 njësi në vitin 2023 dhe 72,000 njësi në vitin 2024.

Megjithatë në këtë marrëveshje nuk ishin përfshirë edhe njësitë e reja të evidentuara në terren, KRM Pastrimi llogaritet të ketë arkëtuar më pak të hyra, mbi 92 mijë euro në muaj, ose rreth 1.1 milion euro në vit. Sipas të dhënave të sistemit të brendshëm të KRM Pastrimi, në vitin 2025 janë faturuar gjithsej 88,762 njësi banimi/klientë, duke vërtetuar rritjen e numrit të faturimeve.

3.3.3. Të hyrat e KRM Pastrimi të mjaftueshme për të mbuluar vetëm kostot operative

Në vitin 2023 KRM Pastrimi kishte arkëtuar gjithsej 6,29 milionë euro, ndërsa në vitin 2024 kanë arritur në 6,68 milionë euro.

Grafiku 2. Krahasimi në mes faturimeve dhe arkëtimeve në KRM Pastrimi



Këto të dhëna tregojnë se sistemi aktual tarifor, për nga niveli i arkëtimit, nuk kishte mundur të sigurojë të hyra të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet faktike të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave.

Në vitin 2025, kur KRM Pastrimi kishte marrë përgjegjësinë për faturim dhe arkëtim, vlera e arkëtimit ishte dukshëm më e ulët se vitet paraprake kur faturimin dhe arkëtimin e kishte bërë Komuna. Deri në tetor 2025, KRM Pastrimi kishte faturuar 5,99 milionë euro, ndërsa kishte arritur të arkëtoj afër 1.29 milion euro ose vetëm 21% të faturimit.

Nga këto të hyra KRM Pastrimi kishte paguar vetëm shpenzimet operative, si pagat e punëtorëve që përbëjnë 66% të totalit të shpenzimeve, nafta dhe vajrat 10%, TVSh-në dhe sigurimet 10% etj. për pasojë gjatë këtyre dy viteve nuk kishe bërë investime kapitale.

Kjo kishte ndodhur për shkak se nga ky vit Kuvendi Komunal ia bartë KRM Pastrimi përgjegjësinë për faturimin dhe arkëtimin e të hyrave nga amvisëritë, me çka Kryetari i Komunës nuk ishte pajtuar, dhe ka bërë thirrje publike se pagesat e faturave duhet të bëhen në Komunë dhe jo te KRM Pastrimi, gjë që kishte shkaktuar konfuzion tek qytetarët.¹³ Çështja kishte përfunduar në Gjykatë dhe nuk ishte zgjidhur deri në nëntor 2025. Prandaj arkëtimi në këtë vit ishte në këtë nivel.

Si rrjedhojë, ekziston rrezik i konsiderueshëm që KRM Pastrimi të përballet me sfida serioze financiare. Edhe në rast të arkëtimin të plotë (100%) të të hyrave të faturuara, KRM Pastrimi ka mundësi se nuk do të jetë në gjendje të sigurojë fonde për investime kapitale.

3.3.4. Angazhimi i operatorëve privat i ka kushtuar Komunës më shtrenjtë

Deri në vitin 2024, KRM Pastrimi ishte e vetmja kompani përgjegjëse për mbledhjen e mbeturinave në Kryeqytet dhe Komuna e kishte paguar atë çmim fiks mujor, bazuar në njësitë e regjistruara të banimit (amvisërive) në territorin e Komunës. Tarifa fikse prej 6.2 euro për njësi banimi, e miratuar në Kuvend Komunal, i kishte sjellë KRM Pastrimi të hyra vjetore prej 6.2 dhe 6.8 milion euro vetëm nga amvisëritë, për vitin 2023 përkatësisht 2024, bazuar në kontratën me Komunën e Prishtinës.

Në vitin 2024 Komuna kishte angazhuar një operator privat për grumbullim të mbeturinave, krahas KRM Pastrimi. Kjo ishte hera e parë që Komuna kishte bërë një gjë të tillë, me arsyetimin e gjendjes emergjente në qytet. Kompensimi/pagesa

13 <https://albanianpost.com/faturat-per-mbeturina-ne-prishtine-do-te-pagohen-permes-komunes-jo-nendermarrjen-krm-pastrimi>

për OE-në privat është bazuar në njësi matëse të ndryshme nga ato të operatorit publik: operatori privat është kompensuar bazuar në performancë, sipas peshës së mbeturinave që ka shkarkuar në deponi. Pra është paguar 64 euro për ton të mbeturinave që ka shkarkuar, si dhe 70 euro në rast se ka pasur nevojë për larje të pikës grumbulluese. Ndërsa, KRM Pastrimi është kompensuar me çmim fiks, pa marrë parasysh peshën e realizuar. Megjithatë gjendja në teren nuk ishte përmirësuar dukshëm krahasuar me gjendjen para angazhimit të OE-ve privat.

Megjithëse të dy operatorët shërbimet i kanë ofruar njëkohësisht, Komuna nuk ka rregulluar përcaktimin dhe ndarjen e zonave të mbulimit ndërmjet dy operatorëve, përmes një dokumenti zyrtar apo marrëveshjeje të shkruar, por është zbatuar përmes dakordimit verbal mes operatorëve. Në këtë kontekst, Komuna ka vazhduar pagesën ndaj KRM Pastrimi sipas vlerës kontraktuale, duke i'a zbritur asaj vlere shumë të madhe që ia ka paguar operatorit privat, ndërkohë që ky i fundit është kompensuar drejtpërdrejt sipas peshës së realizuar.

Ne kemi analizuar ndikimin financiar për Komunën angazhimi i operatorit privat, me qëllim të vlerësimit se cili opcion i ofrimit të shërbimit të mbledhjes së mbeturinave ka qenë më ekonomik. Analiza është realizuar për periudhën prill-dhjetor 2024, periudhë gjatë së cilës OE privat ka ofruar shërbimin e gurbullimit të mbeturinave. Analiza është bazuar në dy elemente: pagesat e realizuara dhe pesha (tonelatat) e mbeturinave, përkatësisht për KRM Pastrimi dhe për OE privat. Këto vlera janë përkthyer në çmim për ton.

Sqarim: a) Në shumën totale të pagesave për KRM Pastrimi janë përfshirë, përveç pagesave nga amvisëritë, edhe pagesat që Komuna realizon për shërbimet e mbledhjes së mbeturinave për institucionet komunale (përfshirë institucionet parashkollë, shkollat, QKMF-të dhe të tjera).

b) Ndërkaq, te çmimi për ton për OE privat është përfshirë edhe pagesa për larjen e pikave ku ndodhen kontejnerët. Për KRM Pastrimi këto shërbime janë të përfshira në çmim të tarifës, sipas marrëveshjes ekzistuese, dhe konsiderohen si pjesë standarde e shërbimit.

Rezultatet e analizës tregojnë se, Komuna ka paguar çmim më të lartë për ton për OE privat, krahasuar me KRM Pastrimi. Konkretisht, çmimi ka rezultuar 61.88

euro/ton për KRM Pastrimi (duke përfshirë mbledhjen e mbeturinave dhe larjet), ndërsa 71.15 euro/ton për OE privat (mbledhja dhe larjet).

Tabela 4. Krahasimi i çmimit të paguar KRM Pastrimit dhe OE-së privat, periudha Prill-Dhjetor 2024

	KRM Pastrimi	OE Privat
Pagesa €	2,921,592€	1,143,238€
Sasia e mbeturinave të mbledhura (ton)	47,212	16,069
Çmimi për ton	61.88€	71.15€

Në disa fatura të operatorit privat është përfshirë edhe çmimi për larjen e pikave grumbulluese si pozicioni i veçantë, që ka ndikuar në ngritjen e çmimit. Megjithatë, Komuna kur ka bërë analizë të çmimit nuk kishte marrë parasysh që çmimi i larjes së pikave grumbulluese është pjesë e shpenzimeve për shërbimet e kryera nga OE privat. Në anën tjetër, në kontratën me KRM Pastrimi, shërbimi i larjes së pikave grumbulluese është i përfshirë në kuadër të çmimit të përgjithshëm për grumbullimin e mbeturinave, pa u trajtuar si pozicioni i ndarë.

Komuna kishte vazhduar me këtë qasje kontraktuese edhe gjatë vitit 2025, kur kishte lidhur kontrata të reja me dy operatorë tjerë privatë, me çmime prej 70 euro/ton për bartje, si dhe 28 euro për larje për OE 1, dhe 70 euro/ton për bartje dhe 25 euro për larje për OE 2. Sipas vlerësimeve të komisioneve të tenderimit, rritja e çmimeve të bartjes është arsyetuar me rritjen e inflacionit, si dhe me pritjen që ky trend rritës të vazhdojë edhe në vitet në vijim.

Komuna është ekspozuar ndaj pagesave më të larta për shërbime të njëjta të grumbullimit të mbeturinave, krahasuar me kushtet e kontraktuara dhe me kontratën ekzistuese me KRM Pastrimi. Kjo ka ndikuar në rritjen e kostos për njësi/peshë të bartur, rrjedhimisht ka rritur shpenzimet e Komunës për këtë shërbim. Pavarësisht kontraktimit të OE-ve privat, Komuna nuk kishte arritur të bëjë përmirësime të dukshme sa i përket grumbullimit të mbeturinave në kryeqytet.

KONKLUZIONEN

04

4. Konkluzionet

Komuna e Prishtinës nuk ishte efikase as efektive në ofrimin e shërbimit për grumbullimin e mbeturinave të amvisërisë, në tri vitet e fundit kryeqyteti është përballur me rënie të cilësisë së këtij shërbimi, duke rezultuar në grumbullimin e mbeturinave në trotuare dhe rrugë.

Kjo ka ndodhur për shkak se ka munguar mbikëqyrja, raportimi, monitorimi dhe llogaridhënia mbi operacionet e mbledhjes së mbeturinave, duke rezultuar në mungesë të kontrollit institucional nga Komuna mbi gjendjen e shërbimeve të mbledhjes së mbeturinave në terren dhe resurset e përdorura për këtë qëllim, që më pas ka rezultuar me menaxhim të dobët të mbledhjes së mbeturinave.

Edhe pse rolet dhe përgjegjësitë ndërmjet Komunës dhe KRM Pastrimi janë të përcaktuara, ato nuk janë zbatuar në mënyrë të plotë nga të dyja palët. Mospërdorimi i mekanizmave efektivë të monitorimit dhe llogaridhënies nga Komuna ka kufizuar mundësinë për të vlerësuar performancën e KRM Pastrimi dhe për të siguruar menaxhim efektiv të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave.

Ndërsa në anën tjetër, KRM Pastrimi nuk ka ndjekur procedurat e raportimit tek Komuna për të siguruar të dhëna të qarta në lidhje me planet operative, apo çështjet që ndërlidhen me ofrimin e shërbimeve të mbledhjes së mbeturinave.

Përveç kësaj Komisioni i Aksionarëve nuk ka arritur të ushtrojë mbikëqyrje ndaj Bordit të Drejtorëve, e as Bordi ndaj KRM Pastrimit.

KRM Pastrimi nuk ka siguruar menaxhim efektiv të flotës së kamionëve, duke mos garantuar ofrim të qëndrueshëm dhe në kohë të shërbimeve sipas objektivave të planifikuara. Janë identifikuar mangësi në planifikimin operacional, në mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe në menaxhimin e aseteve, të cilat kanë ndikuar në uljen e disponueshmërisë së mjeteve operative dhe në performancën e përgjithshme të shërbimit.

Mungesa e një qasjeje strategjike për mirëmbajtjen e flotës, investimet e vonuara në blerjen e kamionëve, kanë rezultuar me nevojën për qiramarrje të kamionëve dhe mbi-përdorim të flotës që kanë çuar në defekte teknike të shpeshta dhe kohë të gjatë për riparim të tyre. Si rezultat, qytetarët kanë vazhduar të ballafaqohen me cilësi të ulët të shërbimeve.

Vonesat në dorëzimin dhe vënien në shfrytëzim të kamionëve të mbeturinave tregojnë mungesë koordinimi dhe menaxhimi efektiv ndërmjet Komunës dhe KRM Pastrimi, duke rezultuar në shfrytëzim joefikas të aseteve publike. Si rrjedhojë, objektivat e performancës për ofrimin e shërbimeve nuk janë mbështetur në kohë me mjetet që tashmë janë pranuar, gjë që ka ndikuar negativisht në efikasitetin dhe cilësinë e shërbimeve të mbledhjes së mbeturinave.

KRM Pastrimi nuk ishte efikase në përdorimin e burimeve të saj, përfshirë menaxhimin operacional, menaxhimin financiar (mbulimi i shpenzimeve) dhe administrimin e aseteve kapitale për funksionim të qëndrueshëm.

Përderisa nuk ka pasur GPS dhe mekanizma të dedikuar për monitorimin e flotës - një pjesë e konsiderueshme e flotës nuk është e pajisur me matës të kilometrave të kaluara - deri në vitin 2025, Komuna dhe KRM Pastrimi kanë pasur kapacitet të kufizuar për mbikëqyrje dhe kontroll të operacioneve të mbledhjes së mbeturinave, duke ndikuar në efikasitetin dhe transparencën e shërbimeve.

Mungesa e një analize të detajuar të nevojave reale në terren, duke përfshirë fluksin e mbeturinave dhe gjendjen e kontenierëve ekzistues, ka ndikuar që shpërndarja e tyre të mos sigurojë shfrytëzim optimal të kapaciteteve të krijuara dhe të mos arrijë nivelin e pritur të përmirësimit të shërbimeve për qytetarët.

Mosrealizimi i trajnimeve të stafit të sapo rekrutuar ka ndikuar drejtpërdrejt në mungesën e kompetencave të nevojshme të stafit operativ, duke rezultuar në dëmtime të shpeshta të kontenierëve dhe joefikasitet operacional.

Edhe pse Komuna nuk ka arritur gjithmonë të arkëtojë të gjithë vlerën e faturuar ndaj qytetarëve, ajo ka arritur të paguaj KRM sipas marrëveshjes.

Megjithatë, pas marrjes së përgjegjësisë për faturimin nga vet KRM, arkëtimi i të hyrave nuk ka shënuar performancë të mirë, gjë që mund të rrezikojë të sjellë KRM-në në gjendje jo të favorshme financiare.

Megjithëse Komuna ka ndërmarrë masa për të siguruar vazhdimësinë e shërbimit përmes kontraktimit të operatorëve privatë, duke pasur parasysh se çmimi për njësi është më i lartë, krahasuar me KRM Pastrimi, si dhe trendi rritës i çmimeve theksojnë nevojën për rishqyrtim të vendimit për angazhim të operatorëve privat para lidhjes së kontratave të reja. Në mungesë të një analize të tillë paraprake dhe të krahasueshme, ekziston rreziku që Komuna të përballet me shpenzime më të larta operative.

05

5. Rekomandimet

Në mënyrë që Komuna e Prishtinës dhe KRM Pastrimi në të ardhmen të menaxhojnë më mirë ofrimin e shërbimeve në grumbullimin e mbeturinave shtëpiake në kryeqytet, rekomandojmë që:

- Komuna dhe Kuvendi Komunal në strukturën e llogaridhënies të emërojnë vetëm zyrtarë të përgjegjshëm dhe me integritet që kryejnë detyrat e besuara (fiduciare) me kompetencë.
- Strukturat përkatëse të marrin veprimet e nevojshme ndaj çdo zyrtari përgjegjës, në rast të performancës së dobët ose në rast të moszbatimit të detyrimeve të besuara (fiduciare).

KRM Pastrimi të sigurohet

- se stafi zhvillon njohuri të nevojshme për të hartuar Plane SMART të Biznesit;
- se Planin Operativ përditësohet sipas nevojave reale,
- se zbatohet mirëmbajtje preventive (kilometrazhi, konsum karburanti dhe disponueshmëri operative), për të siguruar efikasitet të shërbimit.
- që çdo investim i ri analizohet paraprakisht dhe lidhet me objektiva konkrete të performancës, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.
- Komuna dhe KRM Pastrimi të forcojnë koordinimin dhe planifikimin operacional për dorëzimin dhe vënien në shfrytëzim të aseteve, duke përcaktuar përgjegjësi konkrete dhe mekanizma monitorimi për zbatimin e marrëveshjeve.
- Komuna të merr hapat e nevojshëm për vendosjen e sistemit GPS për gjithë flotën e kamionëve dhe të caktojë personel të dedikuar ekskluzivisht për monitorimin e flotës.
- Komuna në bashkëpunim me KRM Pastrimin të bazojë planifikimin e furnizimit dhe vendosjes së kontenierëve në analiza të strukturuar të

nevojave reale në terren, duke përfshirë numrin e njësive të banimit për pikë grumbullimi, fluksin e mbeturinave dhe gjendjen funksionale të kontenierëve ekzistues.

- KRM Pastrimi të zhvillojë një program të strukturuar trajnimi për stafin operativ, me qëllim rritjen e njohurive dhe aftësive për përdorimin e sigurt dhe korrekt të kontenierëve.
- KRM Pastrimi të përmirësojë mekanizmat për arkëtimin e plotë të faturave, për të rritur qëndrueshmërinë financiare dhe kapacitetin për ofrimin efikas të shërbimeve.
- Komuna të bëjë një analizë krahasuese të kostos para lidhjes së çdo kontrate për shërbimin e mbledhjes së mbeturinave, duke përfshirë të gjitha komponentët e çmimit (mbledhje, larje, dhe shërbime shtesë).

Shtojca 1. Kriteret, fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Problemi i auditimit

Në vitet e fundit, menaxhimi i mbeturinave të amvisërisë në Komunën e Prishtinës është përballur me sfida të konsiderueshme, duke reflektuar një performancë të dobët institucionale dhe koordinim të mangët ndërmjet akterëve përgjegjës. Ky problem është thelluar për shkak të mungesës së një qasjeje strategjike dhe mungesës së zbatueshmërisë së politikave dhe rregulloreve të miratuara. Një auditim për këtë situatë të shkaktuar është i nevojshëm për të identifikuar shkaktarët e dobësive në menaxhim dhe për të rekomanduar masa për përmirësim të qëndrueshëm.

Ndryshimi i shpesht i rregulloreve ka shkatuar konfuzion operacional dhe mungesë të standardeve të qarta për përgjegjësitë e palëve të përfshira. Rast konkret është rregullorja e re për mbeturinat që hyri në fuqi në vitin 2023¹⁴, ku kjo rregullore i jep të drejtë Komunës të kontrakttoj kompani private, nëse KRM Pastrimi ka vështirësi për operim.

Mosmarrëveshjet e vazhdueshme ndërmjet Komunës së Prishtinës dhe KRM Pastrimi kanë dëmtuar ndjeshëm ofrimin e shërbimeve për qytetarët¹⁵. Këto mosmarrëveshje kanë filluar kur Komuna përveç ndërmarrjes publike, ka angazhuar edhe kompani private me qëllim të arritjes së objektivave për

14 https://prishtinaonline.com/uploads/1_rregullorja_per_menagjimin_e_mbeturinave.pdf

15 <https://kallxo.com/komuna/kriza-me-mbeturinat-kryetari-perparim-rama-e-shpalli-gjendjen-e-jashtezakonshme/>

mirëmbajtjen e mjedisit¹⁶. Konfliktet mes tyre kanë të bëjnë me financimin, planifikimin e operacioneve dhe kompetencat institucionale. Në disa raste, KRM Pastrimi ka paralajmëruar me ndërprerje të shërbimeve për shkak të mungesës së përkrahjes financiare nga Komuna, ndërsa vetë Komuna ka akuzuar ndërmarrjen për neglizhencë dhe mungesë të transparencës.

Një problem tjetër thelbësor është niveli i ulët i pagesës së faturave nga qytetarët, i cili është përkeqësuar nga paqartësia lidhur me institucionin përkatës ku ata duhet t'i kryejnë pagesat¹⁷. Mungesa e një mekanizmi efektiv për mbledhjen e të hyrave ka ndikuar në pamundësinë e investimeve në pajisje dhe burime njerëzore, duke e bërë sistemin e menaxhimit të mbeturinave të paqëndrueshëm.

Si përfundim, grumbullimi jo i rregullt i mbeturinave në Prishtinë ka shkaktuar ndikime të konsiderueshme në mjedis dhe paraqet rrezik serioz për shëndetin e qytetarëve. Vonesat në grumbullim dhe qëndrimi i zgjatur i mbeturinave në hapësira publike kontribuojnë në ndotjen e ajrit, duke krijuar kushte të favorshme për përhapjen e infeksioneve dhe sëmundjeve të ndryshme. Prania e insekteve, brejtësve dhe kafshëve endacake rritë edhe më shumë rrezikun për komunitetin. Në këtë rast, mosfunksionimi i duhur i sistemit të menaxhimit të mbeturinave nuk paraqet vetëm një dështim institucional, por edhe një kërcënim të drejtpërdrejtë për mirëqenien publike dhe ruajtjen e mjedisit.

Përshkrimi i sistemit dhe akterët relevant

Menaxhimi i mbeturinave në nivel shtetëror në Kosovë rregullohet përmes një procesi të integruar ligjor dhe strategjik, i cili përcakton përgjegjësitë e institucioneve shtetërore dhe lokale. Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Mbeturinave 2023–2030 është dokumenti udhëheqës për zhvillimin e qëndrueshëm të këtij sektori, duke përcaktuar objektiva për reduktimin e mbeturinave, riciklimin dhe përmirësimin e shërbimeve në të gjithë territorin.

16 https://telegrafi.com/pastrimi-pergjigjet-komunes-se-prishtines-ju-keni-vendosur-cdo-kusht-qe-menaxhimi-mbeturinave-ti-jepet-nje-kompanie-private-dhe-qe-pastrimi-te-eliminohet-plotesish/?utm_

17 <https://telegrafi.com/vazhdon-pacartesia-per-pagesen-e-mbeturinave-krm-pastrimi-komuna-po-shkel-rregulloren-faturat-paguhen-tek-ne/>

Ligji¹⁸ për Menaxhimin e Mbeturinave përcakton qartë rolin e institucioneve shtetërore, ku Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka përgjegjësi për hartimin e politikave, mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe koordinimin e veprimtarive në nivel kombëtar. Ndërkohë, komunat, sipas këtij ligji dhe në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, janë autoritetet përgjegjëse për organizimin dhe ofrimin e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave në territorin e tyre, përmes ndërmarrjeve komunale ose rajonale, duke pasur përgjegjësi të drejtpërdrejtë për zbatimin praktik të politikave dhe standardeve të miratuara në nivel shtetëror.

Përgjegjësi kryesor për menaxhim të mbeturinave në kryeqytet është Komuna e Prishtinës, e cila ka për detyrë organizimin, planifikimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të menaxhimit të mbeturinave në territorin e saj.

Kuvendi Komunal nxjerr dhe miraton rregullore ndërsa Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim (përkatësisht Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave) planifikon buxhete, harton politika lokale dhe monitoron ofruesit e shërbimeve publike.

Kompania Rajonale e Mbeturinave 'Pastrimi', ndërmarrje publike e organizuar si shoqëri aksionare, në të cilën Komuna e Prishtinës ka pjesën më të madhe të aksioneve, është përgjegjëse për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave. Ajo e zbaton këtë përgjegjësi duke menaxhuar organizimin dhe realizimin teknik të këtyre proceseve sipas zonave të caktuara, mirëmbajtjen e mjeteve dhe pajisjeve të punës, si dhe menaxhimin e stafit operativ. Ajo ka obligim të raportojë rregullisht te Komuna për çështjet operacionale dhe financiare bazuar në Ligjin për Ndërmarrjet Publike, dhe të veprojë në përputhje me kontratat dhe marrëveshjet përkatëse.

Përfaqësimi i Komunës si aksionare realizohet përmes Komisionit Komunal të Aksionarëve, i cili ushtron të drejtën e mbikëqyrjes dhe marrjes së vendimeve në emër të Komunës lidhur me funksionimin e KRM 'Pastrimi'. Këtij Komisioni i raporton Bordi i Drejtorëve të KRM Pastrimi. Ky Bord është përgjegjës për të marrë vendime strategjike për funksionimin e përditshëm të KRM-së.

18 Nr. 02/L-30 për Menaxhimin e Mbeturinave (i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-060)

Kryeshefi ekzekutiv i KRM Pastrimi është përgjegjës për planifikim, organizimin dhe ekzekutim të planeve të biznesit dhe planeve operative të cilat paraprakisht miratohen nga Bordi i Drejtorëve.

Tabela 5. Përgjegjësitë e palëve në procesin e raportimit, monitorimit dhe llogaridhënies

Emri i Entitetit	Përgjegjësitë Kryesore	Hierarkia e Raportimit	Produktet Kryesore	Autoriteti për Emërim ose Shkarkim
Komuna e Prishtinës Kuvendi Komunal (Autoritet i Nivelit të Lartë)	Organizimi, planifikimi dhe mbikëqyrja e sistemit të menaxhimit të mbeturinave në territorin e saj.	Delegon përgjegjësitë të KRM Pastrimi përmes Komisionit të Aksionarëve.		Emëron anëtarët e Komisionit të Aksionarëve; mund të rekomandojë shkarkimin ose zëvendësimin e anëtarëve të Komisionit për performancë të dobët
Komisioni i Aksionarëve (Organ Mbikëqyrës)	Shqyrton dhe vlerëson punën e Bordit të Drejtorëve.	Mbikëqyr Bordin e Drejtorëve; pranon raporte nga Bordi.	Vlerësime të performancës së Bordit.	Emëron anëtarët e Bordit; mund të rekomandojë shkarkimin ose zëvendësimin e anëtarëve të Bordit për performancë të dobët.
Bordi i Drejtorëve (Organ Ekzekutiv)	Miraton planet afariste dhe operative, shqyrton raportet periodike dhe vlerëson arritjen e objektivave.	I raporton Komisionit të Aksionarëve; mbikëqyr Kryeshefin Ekzekutiv.	Raporte vjetore të punës.	Mund të rekomandojë shkarkimin ose zëvendësimin e Kryeshefit Ekzekutiv për performancë të dobët.
KRM Pastrimi (Operative)	Hartimi i planeve afariste dhe operative.	Raporton në baza tremujore dhe vjetore të Bordi i Drejtorëve.	Plan afarist dhe plan operativ.	

Pyetjet e auditimit

Për t'iu përgjigjur objektivës së auditimit, ne kemi parashtruar pyetjen dhe nën pyetjet e auditimit si në vijim:

1. A është Komuna efektive dhe efikase në menaxhimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave në kryeqytet?
 - A ka Komuna mbikëqyrje të duhur dhe llogaridhënie për performancën e KRM Pastrimi?
 - A është KRM Pastrimi efikase në përdorimin e burimeve të saj, përfshirë menaxhimin operacional (optimizimi i rrugëve, flota, stafi), menaxhimin financiar (mbulimi i shpenzimeve, buxheti, kostoja për ton) dhe administrimin e aseteve kapitale për funksionim të qëndrueshëm?
 - A është Komuna efektive në krijimin e një sistemi të qëndrueshëm tarifor, përfshirë monitorimin e faturimit dhe mbledhjen e të hyrave për sigurimin e qëndrueshmërisë financiar të KRM Pastrimi?
 - A ka siguruar Komuna planifikim financiar dhe fonde të qëndrueshme për investime afatgjata në shërbimet e pastrimit?

Kriteret e auditimit

Qëllimi i këtij auditimi është të vlerësojë nëse Komuna dhe ndërmarrja publike KRM Pastrimi kanë ofruar shërbim të mjaftueshëm për grumbullimin e mbeturinave që përmbushë nevojat e qytetarëve, duke përdorur në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme burimet publike.

Kriteret e auditimit në këtë auditim rrjedhin nga rregulloret e aprovuara nga Kuvendi Komunal dhe kontratatave të lidhura mes këtyre dy institucioneve.

- Komuna duhet të krijojë mekanizma efektivë për monitorimin dhe raportimin e performancës së ndërmarrjes publike që menaxhon mbeturinat në kryeqytet. Këto duhet të përfshijnë objektiva të matshëm, mbledhje

të rregullt të të dhënave, raporte periodike dhe analizë sistematike të rezultateve për rritjen e efikasitetit dhe llogaridhënies së KRM Pastrimi.¹⁹

- Komuna është përgjegjëse për sigurimin e burimeve të mjaftueshme financiare për ofrimin efektiv të shërbimeve publike dhe për garantimin e stabilitetit financiar, përmes planifikimit të një buxheti adekuat dhe ndarjes së fondeve në përputhje me kërkesat ligjore.²⁰
- Komuna duhet të ketë një planifikim financiar afatmesëm dhe afatgjatë të harmonizuar me objektivat strategjike për shërbimet e pastrimit, duke siguruar ndarjen e qëndrueshme të fondeve për investime kapitale që garantojnë zhvillim dhe përmirësim të vazhdueshëm të infrastrukturës dhe cilësisë së shërbimeve.
- KRM Pastrimi duhet të ketë plane të detajuara për shfrytëzimin e infrastrukturës dhe pajisjeve në dispozicion, përfshirë automjetet (kamionë, kontejnerë, etj.) dhe burimet njerëzore, në mënyrë të koordinuar dhe efikase për zbatimin e planit operativ. Kjo përfshin sigurimin që infrastruktura e nevojshme të jetë mirëmbajtur dhe e gatshme për përdorim, dhe që stafi të jetë i trajnuar dhe i angazhuar në realizimin e detyrave të planifikuara. Përdorimi efikas i burimeve duhet të garantojë që aktivitetet e planifikuara për mbledhjen dhe menaxhimin e mbeturinave të realizohen sipas afateve dhe standardeve të përcaktuara²¹.

Fushëveprimi i auditimit

Fushëveprimi i këtij auditimi përfshinë vlerësimin e sistemit të grumbullimit të mbeturinave nga Komuna e Prishtinës dhe ndërmarrja publike KRM Pastrimi, për periudhën 2023–2024. Kemi analizuar mënyrën se si Komuna ka planifikuar, financuar, mbikëqyrur dhe mbështetur ofrimin e këtij shërbimi publik, si dhe nëse janë ndërmarrë veprime konkrete për të siguruar mbulueshmëri të plotë dhe përdorim racional të burimeve.

19 Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave 2023

20 Plani Komunal i Menaxhimit të Mbeturinave 2023-2027

21 Plani Operativ i KRM Pastrimi dhe Plani i Biznesit 2024 dhe 2025

Metodologjia e Auditimit

Në kuadër të këtij auditimi janë analizuar gjithashtu aktivitetet dhe kapacitetet operacionale të KRM Pastrimi, duke përfshirë strukturën organizative, planifikimin strategjik dhe operativ, menaxhimin e burimeve njerëzore dhe materiale, si dhe sistemet për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave të performancës. Kemi shqyrtuar nëse ndërmarrja ka qenë në gjendje të ofrojë shërbimet në mënyrë të vazhdueshme, efikase dhe të qëndrueshme gjatë viteve 2023 dhe 2024, si dhe nëse janë ndërmarrë masa për përmirësim të vazhdueshëm dhe përballje me sfida të papritura.

Për t'iu përgjigjur pyetjeve të auditimit, ekipi i auditimit ka kryer disa aktivitete në institucionet përgjegjëse duke përdorur një sërë teknikash audituese, si:

- Vlerësimi i realizimit të planeve strategjike operative
- Analizimin e kornizës ligjore dhe rregullative të KRM Pastrimi
- Analizimin e kornizës ligjore dhe rregullative të Komunës së Prishtinës, përkatësisht Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit (Sektori për Menaxhimin e mbeturinave dhe mjedisit)
- Intervistimin e personave përgjegjës dhe strukturave udhëheqëse të KRM Pastrimi;
- Intervista me zyrtarët e Komunës së Prishtinës;
- Analizën e planeve vjetore të punës, planeve operative, të biznesit, raportimeve dhe realizimin e tyre nga palët përgjegjëse;
- Analizën e rrugëve të grumbullimit dhe shfrytëzimit të flotës, analizën e të dhënave buxhetore dhe shpenzimeve reale kundrejt planit, dhe planifikimin e investimeve dhe krahasimin e tyre me nevojat operacionale;
- Vizitë e befasishme gjatë auditimit (ndonjë pikë që e mbulon kompania e kontraktuar private si dhe ndonjë pikë të mbuluar nga KRM Pastrimi); dhe
- Analizë e kontratave të prokurimit me kompaninë private si dhe menaxhimin e kontratës.

Gjatë këtij auditimi parashohim që të përballemi me disa rreziqe që mund të kenë ndikim në aktivitetet e auditimit, si më poshtë:

Rreziku i auditimit	Lartë	Mesatar	Ulët
Ndryshimi i shpeshtë i korinzës ligjore	X		
Informata kundërthënëse nga entitetet përgjegjëse		X	
Ndryshimet e menaxhmentit në institucionet përkatëse		X	

Ndryshimet ligjore - plotësim-ndryshimet e rregulloreve të miratuara nga Kuvendi Komunal, që ndikojnë drejtpërdrejt në veprimtarinë e ndërmarrjes KRM «Pastrimi», kanë krijuar situata të paqarta dhe jo të standardizuara në aspektin operacional dhe financiar. Si pasojë, mund të vështirësohet gjurmueshmëria e vendimeve menaxheriale, pajtueshmëria me kuadrin rregullativ dhe siguria e të dhënave financiare dhe operative.

Përgjigja ndaj rrezikut: për të adresuar paqartësitë e krijuara nga ndryshimet e shpeshta dhe të rregulloreve komunale që ndikojnë në veprimtarinë e KRM Pastrimi, auditimi është përqendrohet në analizimin kronologjik të ndryshimeve ligjore dhe ndikimin e tyre konkret në operacionet dhe financat e ndërmarrjes. Kemi realizuar krahasim midis versioneve të rregulloreve, shqyrtim i dokumentacionit mbështetës dhe intervistim i zyrtarëve komunalë dhe të ndërmarrjes për të sqaruar procesin vendimmarrës.

Informata kundërthënëse nga entitetet përgjegjëse: kjo mund të krijoj pa qartësi, konfuzion dhe interpretim të gabuar të të dhënave dhe rolit të secilit institucion.

Përgjigja ndaj rrezikut: për të siguruar saktësi, kemi krahasuar dokumentet zyrtare të të dy palëve, kemi zhvilluar intervista me personat përgjegjës dhe kemi analizuar bazën ligjore për të identifikuar përgjegjësitë e qarta.

Ndryshimet e menaxhmentit në institucionet përkatëse - rreziku si ndërrimi i menaxhmentit, strukturës organizative apo politikave të brendshme, mund të shkaktojë paqartësi, mungesë të vijueshmërisë dhe vështirësi në sigurimin e

informacioneve të besueshme. Kjo rritë pasigurinë në procesin e auditimit dhe ndikon negativisht në vlerësimin e kontrollit të brendshëm dhe llogaridhënies.

Përgjigja ndaj rrezikut: planifikojmë të bëjmë rishikimin e dokumentacionit të politikave dhe procedurave për të siguruar që ato ofrojnë udhëzime të qarta dhe konsistente për menaxhimin e këtyre ndryshimeve dhe vlerësimin e kontrolleve të brendshme për të siguruar që ato janë të mjaftueshme për të ruajtur vazhdimësinë e operacioneve.

Shtojca 2: Letër konfirmimi



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE "PASTRIMI" SILVA

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës "Efikasiteti dhe efektiviteti i grumbullimit të mbeturinave të amvisërisë në kryeqytet", dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit
Vendi dhe data: Prishtinë, 03.04.2026.

I/e nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit "Efikasiteti dhe efektiviteti i grumbullimit të mbeturinave të amvisërisë në kryeqytet" (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Kryetari/Kryeshefi Ekzekutiv

Petrit Reçica



Shtojca 3: Vlerësimi i planit të biznesit të KRM Pastrimi

Vlerësimi jonë i objektivave të KRM “Pastrimi” Sh.A. rezulton se ato janë një përzierje mes synimeve të përgjithshme strategjike dhe shifrave specifike financiare. Nëse i analizojmë përmes kornizës SMART (Specifike, Të matshme, Të arritshme, Relevante dhe Të kufizuara në kohë), rezultati është si vijon:

1. Specifike (Specific)

- Vlerësimi: Objektivat kryesore në lista (si “Digjitalizimi” ose “Decentralizimi”) janë më shumë kategori strategjike sesa detyra specifike.

2. Të matshme (Measurable)

- Vlerësimi: Listat e “Objektivave Kryesore” nuk përmbajnë shifra (p.sh. nuk thuhet “rritje prej 10%”), që i bën ato të vështira për t’u matur vetëm si tekst.
- Pikë e fortë: Megjithatë, këto objektiva bëhen të matshme përmes tabelave financiare dhe investimeve. Për shembull, synimi për rritjen e kapaciteteve teknike matet me vlerën prej 2,860,000 € të planifikuar për investime në vitin 2024.

3. Të arritshme (Achievable)

- Vlerësimi: Arritshmëria mbetet sfiduese pasi kompania operon në “kushte të kufizuara” dhe varet nga faktorë të jashtëm si çmimi i naftës dhe donatorët.
- Lidhshmëria: Planet varen shumë nga bashkë-financimi me komunitat dhe organizatat ndërkombëtare (si KFW apo GIZ), që do të thotë se arritja e tyre nuk është 100% nën kontrollin e brendshëm të kompanisë.

4. Relevante (Relevant)

- Vlerësimi: Ky është kriteri ku planet shkëlqejnë. Të gjitha objektivat janë drejtpërdrejt të lidhura me misionin e kompanisë për grumbullimin e mbeturinave dhe higjienën publike.

5. Të kufizuara në kohë (Time-bound)


- Vlerësimi: Planet janë të kufizuara brenda viteve fiskale (2024, 2025).

Përmbledhje e Vlerësimit SMART

Kriteri	Statusi	Komenti
Specifike	Mesatar	Mungojnë detajet se “si” do të realizohet digjitalizimi.
Të matshme	Lartë	Maten përmes buxheteve dhe tabelave të inkasimit.
Të arritshme	Mesatar	Varen nga donatorët dhe stabiliteti i çmimeve globale.
Relevante	Shumë Lartë	Adresojnë nevojat kritike të higjienës dhe mjedisit.
Koha	Lartë	Cikli i raportimit 3-mujor mban përgjegjësinë kohore.

Përfundim: Objektivat e KRM “Pastrimi” janë pjesërisht SMART. Ato janë shumë relevante dhe të matshme nga ana financiare, por lista e objektivave kryesore do të përfitonte nga specifikime më të qarta operationale (p.sh. “Blerja e 5 kamionëve deri në qershor” në vend të “Shtimi i numrit të kamionëve”).

Meqë ekziston një afat i qartë ligjor për raportim, pra menaxhmenti duhet të raportojë çdo 3 muaj dhe të dorëzojë raportin vjetor 45 ditë pas përfundimit të vitit, detyrimisht objektivat duhet të kenë një afat kohor për realizim, por që nuk e kanë.

A blurred city street scene with modern buildings and a yellow trash bin in the foreground. The image has a green tint. The text is located in the bottom left corner.

Zyra Kombëtare e Auditimit
Lagjja Arbëria
Rr. Ahmet Krasniqi, 210
10000 Prishtina
Republika e Kosovës